



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURRENCËS

**UNIVERSITETI I ELBASANIT
“ALEKSANDËR XHUVANI”**

Nr. 432 Prot.

Tiranë më 25/10/2017

Nr. 1383 Prot.

Elbasan, më 25/10/2017

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PËR

**“ZHVILLIMIN E NISMAVE DHE AKTIVITETEVE TË
PËRBASHKËTA”**

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI", përfaqësuar nga Rektori
i Universitetit, Prof. Dr. Skënder Topi

dhe

AUTORITETI I KONKURENCËS, përfaqësuar nga Kryetari Prof. Dr. **Juliana Latifi**
më poshtë referuar si palët;

Nisur nga interesat e përbashkëta që lidhen me promovimin, edukimin qytetar dhe pjesëmarrjen aktive, me synim rritjen e ndërgjegjësimit për çështje të arsimit të lartë dhe mbrojtjes së konkurrencës së lirë e efektive treg, si të mira publike këto, për zhvillimin e nismave dhe aktiviteteve të përbashkëta, palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum bashkëpunimi sipas dispozitave më poshtë:

NENI 1

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi është përcaktimi i procedurës dhe vendosja e rregullave të bashkëpunimit dypalësh, në mënyrë që të sigurohet realizimi i nismave e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të arsimit të lartë dhe konkurrencës së lirë dhe efektive.

NENI 2

BAZA LIGJORE

Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshje, palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore si më poshtë:

- Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ;
- Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.

NENI 3

PARIME TË PËRGJITHSHME

- 3.1 Ky Memorandum lidhet për të lehtësuar marrëdhëniet ndërinstitucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me synim

komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- 3.2 Ky Memorandum shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Kjo marrëveshje nuk ndryshon ndonjë ligj ose akt nënligjor në fuqi. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë memorandum nuk cenojnë apo ndikojnë tek të drejtat dhe detyrimet që i burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.
- 3.3 Palët njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesave rregullatore.

NENI 4

FORMAT DHE MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT

- 4.1 Bashkëpunimi midis palëve do të realizohet me anë të takimeve të përbashkëta apo shkëmbimit të informacionit.
- 4.2 Kërkesa për informacion ose takim do t'i drejtohet palës tjetër me shkrim dhe në gjuhën shqipe.
- 4.3 Kërkesa për informacion ose takim duhet të sigurojë një përshkrim të përgjithshëm lidhur me subjektin për të cilin kërkohet bashkëpunimi dhe kohën e dëshiruar për konkretizimin e bashkëpunimit.
- 4.4 Pala së cilës i drejtohet kërkesa, pasi e analizon atë, i siguron palës tjetër informacionin që ai zotëron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, pala së cilës i drejtohet kërkesa duhet t'i japë përgjigjen me shkrim palës që kërkon informacionin, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënien e informacionit.

NENI 5

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

- 5.1 Palët për zbatimin e këtij memorandumi caktojnë nga një person kontakti/koordinator për secilin institucion.
- 5.2 Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni.

- 5.3 Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e të dy institucioneve në lidhje me zbatimin e bashkëpunimit.
- 5.4 Me qëllim lehtësimin dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm për zbatimin kësaj marrëveshje, Palët bien dakord që të caktojnë personat dhe mënyrën e kontaktit midis tyre, sipas Anex 1 bashkëlidhur këtij memorandum.

NENI 6

DISPOZITA TË FUNDIT

- 6.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
- 6.2 Ky Memorandum mund të ndryshohet vetëm me shkrim.

NENI 7

KOHËZGJATJA DHE HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum lidhet për një afat kohor 1 (një) vjeçar dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Ky Memorandum hartohet në gjuhën shqipe, në katër kopje origjinale, dy për secilën palë.

Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të të dyja palëve, të cilat e firmosin dhe e vulosin atë respektivisht.

PËR
AUTORITETIN E KONKURRENCËS

KRYETARI

Prof. Dr. Juliana LATIFI



PËR
UNIVERSITETIN "Aleksandër Xhuvani"

REKTORI

Prof. Dr. Skënder TOPI



ANEX 1

Për Autoritetin: Znj. Jonida Koçi
Tel. 04 2234 504
e-mail: jonida.koci@caa.gov.al

Për Universitetin: Znj. Eda Çela
Tel: 355 69 5126263
e-mail: eda.cela@uniel.edu.al